



LICENCIMI I KLUBEVE DHE SHKOLLAVE PRANË FBK-SË

E
D
I
C
I
O
N
I

2
0
2
5
-
2
0
2
6

PËRMBAJTJA

-I- HYRJE

-II-ÇKA ËSHTË LICENCIMI I KLUBEVE?

-III-KRITERET PËR EDICIONIN 2025/2026

-IV- KRITERI SPORTIV

-V- KRITERI FINANCIAR

-VI- KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR

-VII- KRITERI ADMINISTRATIV DHE I PERSONELIT

-VIII- KRITERI INFRASTRUKTUROR

-IX- KATEGORIZIMI I LICENCAVE

-X- PËRMBLEDHJE – DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM PËR LICENCIM

-XI- ANEKSI I, II DHE III

-XII- PËRFITIMET DHE HISEDARËT

PËRMBAJTJA

- XIII- OBLIGIMET PËR 10 %TË BUXHETIT PËR GJENERATAT E REJA
- XIV- RREGULLORJA E VEÇANTË PËR SHPENZIMET E GJENERATAVE TË REJA
- XV- MONITORIMI GJATË EDICIONIT
- XVI- E DREJTA PËR ANKESE
- XVII- AFATET PËR APLIKIM DHE PUBLIKIM VENDIMESH
- XVIII- PSE NUK DUHET TË APLIKOHET POENTIMI NË EDICIONIN 2025/26
- XIX- AFATET

HYRJE

- ❑ Kriteret për licencimin e klubeve dhe shkollave të basketbollit në Kosovë luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e cilësisë, integritetit, sigurisë dhe stabilitetit financiar të ligës.
- ❑ Ato janë të dizajnuara për të siguruar që klubet dhe shkollat e licencuara të basketbollit në Kosovë të jenë në gjendje të konkurrojnë në një nivel të caktuar, të ruajnë stabilitetin financiar dhe të operojnë në mënyrë të sigurt dhe etike.
- ❑ Është e rëndësishme që klubet dhe shkollat e basketbollit të plotësojnë kriteret për licencim për të garantuar cilësinë, integritetin dhe sigurinë e sportit. Megjithatë, klubet dhe shkollat mund të përballen me sfida në përmbushjen e këtyre kërkesave, andaj është e rëndësishme që organet drejtuese të FBK-së të punojnë me klubet dhe shkollat për të siguruar që ato të kenë mbështetjen dhe burimet që u nevojiten për të përmbushur kriteret.

ÇKA ËSHTË LICENCIMI I KLUBEVE?



- **PAKO KRITERESH QË DUHET PËRMBUSHUR QË KLUBET TË KENË TË DREJTË PJEËMARRJE NË GARAT E FBK-SË**



- Sigurimi i standardeve të larta
- Përmirësimi i nivelit të lojës
- Siguria dhe mirëqenia e lojtarëve
- Transparenca dhe llogaridhënia
- Zhvillimi i të rinjve
- Integrimi në gara ndërkombëtare
- Rritja e besimit të publikut dhe sponsorëve

Theks i vecantë do ti kushtohet ngritjes së nivelit të kriterit sportiv dhe atij financiar, më saktësisht të punës me gjenerata të reja, ku edhe do të ketë kontrollë më të madhe për punën dhe investimet që do të bëhen në gjeneratat e reja.

KRITERET PËR EDICIONIN 2025/2026

KRITERI SPORTIV

KRITERI FINANCIAR

KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR

KRITERI ADMINISTRATIV DHE I PERSONELIT

KRITERI INFRASTRUKTUROR

**për përmbushjen e secilit kriter, duhet bashkëngjitur dëshmitë përkatëse*

KRITERI SPORTIV




Klubet duhet të regjistrojnë lojtarët në FBK, të respektojnë rregulloret garuese dhe të kenë ekipe të kategorive të reja sipas nivelit të licencimit.

Programi vjetor i trajnimit për grupmoshat U10–U18

- ✓ Klubet e Superligës Meshkuj janë të obliguara të dorëzojnë një program vjetor stërvitor për secilën grupmoshë;
- ✓ Programi duhet të jetë në përputhje me udhëzuesin e miratuar nga FBK;
- ✓ FBK ofron një kornizë orientuese për planifikimin sezonal dhe ngarkesat javore;
- ✓ Ky program është dokument i detyrueshëm për licencim dhe do të vlerësohet nga zyra teknike e FBK-së dhe Komisioni për Licencim.

KRITERI FINANCIAR



Klubet duhet të dorëzojnë raport financiar, raport të auditimit dhe plan financiar vjetor, duke siguruar stabilitetin financiar.

* Shlyerja e borxheve ndaj FIBA-s është kusht i domosdoshëm për licencim.

* Obligimet aktuale në FBK duhet të paguhet si përmbushje e kriterëve, 50%, kurse pjesa tjetër e borxhit duhet të programohet dhe të paguhet konform marrëveshjes së përgatitur nga FBK dhe nënshkruar nga të dyja palët.

Klubet duhet të demonstrojnë stabilitet financiar, duke përfshirë dhënien e raporteve financiare, duke demonstruar se kanë paguar çdo borxh të papaguar dhe duke treguar se kanë burime të mjaftueshme financiare për të operuar gjatë edicionit.

KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR




Klubet duhet të sigurojnë dëshmi se janë të regjistruar si person juridik, kanë paguar të gjitha taksat dhe tarifat e nevojshme dhe të jenë në përputhje me të gjitha rregulloret ligjore përkatëse. Klubet duhet të respektojnë të gjitha rregulloret përkatëse etike dhe disiplinore, duke përfshirë lojën e ndershme, politikat kundër dopingut dhe kundër racizmit. Kjo përfshin shmangien e çdo sjelljeje të paligjshme ose joetike, promovimin e lojës së ndershme dhe sjelljen e mirë sportive dhe ruajtjen e vlerave të sportit

Klubet janë të obliguara të zbatojnë Politikat e Mbrojtjes të miratuara nga FBK, të cilat përfshijnë:

- ✓ Mbrojtjen e të miturve dhe të gjitha kategorive të ndjeshme;
 - ✓ Emërimin e një personi përgjegjës për këtë fushë;
 - ✓ Raportim të detyrueshëm në rast të sjelljeve të papërshtatshme;
 - ✓ Trajnime për stafin dhe informim për lojtarët dhe prindërit.
- Ky është një kriter etik dhe ligjor në përputhje me standardet e FIBA-s dhe Ligjin për Sport.

**KRITERI
ADMINISTRATIV DHE I
PERSONELIT**



Klubet e basketbollit duhet të ketë personel të kualifikuar, duke përfshirë këtu trajnerët dhe stafin administrativ. Ky personel duhet të ketë kualifikimet dhe përvojën e nevojshme për të menaxhuar ekipin në mënyrë efektive.

**KRITERI
INFRASTRU-
KTUROR**

Klubet duhet të dëshmojnë se objektet e tyre plotësojnë disa standarde për sigurinë, higjienën dhe qasjen.

KATEGORIZIMI I LICENCAVE

- **Superliga Meshkujt:** minimum 5 ekipe të kategorive të reja (U10, U12, U14, U16 dhe U18) (**Licenca A**)
- **Superliga Femrat:** minimum 3 ekipe: U12, U14 dhe U16 (**Licenca A**)
- **Liga e Parë Meshkujt:** minimum 2 ekipe prej U14, U16, U18 dhe Minibasketboll (**Licenca B**)
- **Liga Zhvillimore U21:** minimum 1 ekip prej U14, U16, U18 dhe Minibasketboll (**Licenca C**)
- **Shkollat e Basketbollit:** minimum 2 ekipe prej U14, U16, U18 dhe Minibasketboll (**Licenca D**)

*Kategorizimi i licencave ka për qëllim diferencimin e subjekteve në bazë të nivelit garues (profesional, gjysmë-profesional apo amator), në mënyrë që kriteret të përkohet me rrethanat, kapacitetin dhe standardin e pritur për atë nivel.

Licenca A			
KLUBI:			
1	Formulari i aplikimit		
2	Letërkonfirmimi për personin e autorizuar		
3	Regjistrimi i lojtarëve (lista)		
4	Kontrolli shëndetësor		
5	Paraqitja e ekipeve të gjeneratave të reja		
6	Programi për Zhvillimin dhe Trajnimin e Gjeneratave të Reja		
7	Programet apo politikat me karakter edukativ apo social		
8	Raporti i Auditimit (Financiar)		
9	Plani Financiar		
10	Konfirmimi bankar		
11	Shlyerja e obligimeve ndaj FBK dhe FIBA (apo Marrëveshja me FBK për shlyerjen e borxheve)		
12	Certifikata e regjistrimit (OJQ)		
13	Akti Themelues		
14	Statuti		
15	Rregullorja Disiplinore		
16	Procesverbali i Kuvendit të fundit		
17	Obligimet ndaj organeve tatimore		
18	Kontratat e lojtarëve (të noterizuara) dhe trajnerëve		
19	Lista e të punësuarve në klub (përfshirë stafin profesional)		
20	Lista e organeve qeverisëse dhe drejtuese të klubit (struktura e Bordit, organet drejtuese)		
21	Ndjekja e kurseve nga FBK/FIBA/KOK		
22	Marrëveshja me Policinë (+skica në rast se ka)		
		KRITERI SPORTIV	
		KRITERI FINANCIAR	
		KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR	
		KRITERI ADM. DHE I PERSONELIT	
		KRITERI INFRASTRUKTUROR	

Licenca B			
KLUBI:			
1	Formulari i aplikimit		
2	Letërkonfirmimi për personin e autorizuar		
3	Regjistrimi i lojtarëve (lista)		
4	Kontrolli shëndetësor		
5	Paraqitja e ekipeve të gjeneratave të reja		
6	Programi për Zhvillimin dhe Trajnimin e Gjeneratave të Reja		
7	Raporti i Auditimit (Financiar)		
8	Plani Financiar		
9	Konfirmimi bankar		
10	Shlyerja e obligimeve ndaj FBK dhe FIBA (apo Marrëveshja me FBK për shlyerjen e borxheve)		
11	Certifikata e regjistrimit (OJQ)		
12	Akti Themelues		
13	Statuti		
14	Rregullorja disiplinore		
15	Procesverbali i Kuvendit të fundit		
16	Obligimet ndaj organeve tatimore		
17	Kontratat e lojtarëve (të noterizuara) dhe trajnerëve		
18	Lista e të punësuarve në klub (përfshirë stafin profesional)		
19	Lista e organeve qeverisëse dhe drejtuese të klubit (struktura e Bordit, organet drejtuese)		
20	Marrëveshja me Policinë (+skica në rast se ka)		
		KRITERI SPORTIV	
		KRITERI FINANCIAR	
		KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR	
		KRITERI ADM. DHE I PERSONELIT	
		KRITERI INFRASTRUKTUROR	

Licenca C			
KLUBI:			
1	Formulari i aplikimit		
2	Letërkonfirmimi për personin e autorizuar		
3	Regjistrimi i lojtarëve (lista)		
4	Kontrolli shëndetësor		
5	Paraqitja e ekipeve të gjeneratave të reja		
6	Programi për Zhvillimin dhe Trajnimin e Gjeneratave të Reja		
7	Raporti i Auditimit apo Raporti Financiar		
8	Plani Financiar		
9	Konfirmimi bankar		
10	Shlyerja e obligimeve ndaj FBK dhe FIBA (apo Marrëveshja me FBK për shlyerjen e borxheve)		
11	Certifikata e Regjistrimit (OJQ)		
12	Akti Themelues		
13	Statuti		
14	Rregullorja disiplinore		
15	Procesverbali i Kuvendit të fundit		
16	Obligimet ndaj organeve tatimore		
17	Kontratat e lojtarëve të noterizuara (në rast se ka kontrata profesionale) dhe trajnerëve		
18	Lista e të punësuarve në klub (përfshirë stafin profesional)		
19	Lista e organeve qeverisëse dhe drejtuese të klubit (struktura e Bordit, organet drejtuese)		
20	Kushtet për ndeshje, stervitje		
		KRITERI SPORTIV	
		KRITERI FINANCIAR	
		KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR	
		KRITERI ADM. DHE I PERSONELIT	
		KRITERI INFRASTRUKTUROR	

Licenca D			
SHKOLLA:			
1	Formulari i aplikimit		
2	Letërkonfirmimi për personin e autorizuar		
3	Regjistrimi i lojtarëve (lista)		
4	Kontrolli shëndetësor		
5	Paraqitja e ekipeve të gjeneratave të reja		
6	Programi për Zhvillimin dhe Trajnimin e Gjeneratave të Reja		
7	Raporti i Auditimit apo Raporti Financiar		
8	Plani Financiar		
9	Konfirmimi bankar		
10	Shlyerja e obligimeve ndaj FBK dhe FIBA (apo Marrëveshja me FBK për shlyerjen e borxheve)		
11	Certifikata e regjistrimit		
12	Statuti		
13	Rregullorja disiplinore		
14	Obligimet ndaj organeve tatimore		
15	Lista e të punësuarve në klub (përfshirë stafin profesional)		
16	Lista e organeve qeverisëse dhe drejtuese të klubit (struktura e Bordit, organet drejtuese)		
17	Kontratata me sallat/palestrat që shfrytëzohen për stervitje dhe ndeshje/terme		
		KRITERI SPORTIV	
		KRITERI FINANCIAR	
		KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR	
		KRITERI ADM. DHE I PERSONELIT	
		KRITERI INFRASTRUKTUROR	

PËRMBLEDHJE – DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM PËR LICENCIM

*Pjesët e theksuara dhe me * janë obligative për licencim, - Shiko licencën për të cilën aplikon klubi apo shkolla juaj*



1.	FORMULARI I APLIKIMIT	(i nënshkruar dhe vulosur) *	
2.	KRITERI SPORTIV	Paraqitja e ekipeve të gjeneratave të reja *	
		Programi për zhvillimin e gjeneratave të reja	
		Lista e lojtarëve (emri, mbiemri, lloji i kontratës) / regjistrimi i lojtarëve në platformën regjistrohu.club (print rosterin) *	
		Programet edukative, komunikimi me tifozë dhe mirëqenia sociale (dëshmi)	
		Kujdesi mjekësor i lojtarëve *	
3.	KRITERI FINANCIAR	Raporti Financiar për edicionin e kaluar *	
		Raporti i Auditimit për vitin e kaluar *	
		Plani Financiar për edicionin 2025/26 (përfshirë investimet e parapara në zhvillimin e gjeneratave të reja) *	
		Konfirmimi bankar *	
		Obligimet ndaj FBK –së (Marrëveshja e nënshkruar për shlyerjen e obligimeve ndaj FBK-së dhe pagesa e 50% të borxhit) *	
		Dëshmia për shlyerjen e të gjitha obligimeve ndaj FIBA-s *	
4.	KRITERI LIGJOR, ETIK DHE DISIPLINOR	Dëshmia për kryerjen e obligimeve ndaj ATK-së (apo Marrëveshja) *	
		Statuti i klubit dhe akti themelues i klubit si OJQ *	
		Rregullore Disiplinore *	
		Kontratat me lojtarët profesional dhe trajnerët *	
5.	KRITERI ADMINISTRATIV DHE I PERSONELIT	Struktura e klubit / Organogrami (anëtarët e Bordit + të gjithë personat e angazhuar në klub dhe pozita që mbajnë) *	
		Lista e trajnerëve të angazhuar *	
		Ndjekja e kurseve/seminareve nga FBK/KOK për administrim sportiv	
6.	KRITERI INFRASTRUKTUROR	Kopja e kontratës për angazhimin e shërbimit policor *	
		Aprovimi i infrastrukturës sipas kushteve të përcaktuara me Propozicionet e Garave dhe konform Rregullave Zyrtare të FIBA-s *	

ANEKS I, II DHE III

ANEKS I: RREGULLORE PËR SHPENZIMET E DEDIKUARA PËR ZHVILLIMIN E GJENERATAVE TË REJA NGA KLUBET E SUPERLIGËS MESHKUJT

Kjo Rregullore ka për qëllim të mbështesë zbatimin e kriterit financiar për Licencën A, pra të përcaktojë detyrimin financiar të klubeve të Superligës Meshkujt për të ndarë një pjesë të buxhetit të tyre vjetor për zhvillimin e gjeneratave të reja, duke specifikuar mënyrën e raportimit dhe monitorimit të këtyre shpenzimeve nga Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK).

ANEKS II: DOKUMENT UDHËZUES – PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN DHE TRAJNIMIN E GJENERATAVE TË REJA

Ky dokument udhëzues është pjesë integrale e kriterëve të licencimit dhe, si i tillë, është detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha klubet dhe shkollat që aplikojnë për licencë në FBK.

Dokumenti ndahet në dy pjesë kryesore:

1. Programi për Zhvillimin e Gjeneratave të Reja
2. Programi Vjetor i Stërvitjeve për Grupmoshat U10–U18

ANEKS III: RREGULLORE PËR MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN E SHKOLLAVE TË BASKETBOLLIT

Kjo rregullore përcakton procedurat, kriteret dhe mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të shkollave të basketbollit të licencuara pranë FBK-së, duke siguruar standarde të përshtatshme edukative, teknike, infrastrukturore dhe etike.

PËRFITIMET DHE HISEDARËT

TRAJNERËT

- Të sigurojnë kualifikimin/licencimin
- Trajnim i vazhdueshëm

PRINDËRIT

- Përmirësimi i trajnimit dhe strukturës
- Politika të sigurisë
- Komunikim më i mirë me prindërit

LOJTARËT

- Përmirësimi i trajnimit
- Mundësi për vullnetarizëm

ADMINISTRATORËT

- Trajnim në qeverisje të mirë
- Gjenerim i të hyrave
- Përmirësim në mbarëvajtjen gjatë ditës së garës

QEVERIA LOKALE

- Zhvillim të objekteve
- Zhvillim të komunitetit

OBLIGIMI PËR 10% TË BUXHETIT PËR GJENERATAT E REJA

Për klubet e
Superligës
Meshkuj



Çdo klub obligohet të ndajë minimum 10% të buxhetit vjetor për zhvillimin e gjeneratave të reja (U10–U18).



Shpenzimet duhet të pasqyrohen në Planin Financiar të dorëzuar në FBK.



Do të kontrollohen nga Bordi i FBK-së.



Mungesa e përmbushjes e penalizon klubin në procesin e licencimit.

RREGULLORJA E VEÇANTË PËR SHPENZIMET E GJENERATAVE TË REJA

Rregullore e re
për transparencë
dhe kontroll

Bordi i FBK-së do të miratojë një rregullore të dedikuar për:



Përcaktimin e shpenzimeve të pranueshme;



Format dhe afatet e raportimit;



Mekanizmat e monitorimit dhe verifikimit.



Zbatimi i kësaj rregulloreje është i detyrueshëm dhe do të auditohet çdo sezon.

MONITORIMI GJATË EDICIONIT

Inspektime gjatë
sezonit 2025/26



FBK rezervon të drejtën të realizojë kontrolle të papritura dhe/ose të planifikuara në klubet e licencuara.



Qëllimi: të verifikohet përmbushja e vazhdueshme e kriterëve të licencimit.



Klubet janë të obliguara të ofrojnë qasje në dokumente dhe aktivitete.



Shkeljet mund të çojnë në pezullim apo revokim licence.

E DREJTA PËR ANKESË

Procedura në rast
refuzimi të
licencës

Klubet që nuk pajtohen me vendimin preliminar për licencim:



Kanë të drejtë ankese brenda 72 orëve nga marrja e njoftimit



Ankesa dërgohet tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së



Vendimi final miratohet nga Bordi i FBK-së.

AFATET PËR APLIKIM DHE PUBLIKIM VENDIMESH

Aplikimi dhe Vendimmarrja



Afati i fundit për aplikim: jo më vonë se 30 ditë para fillimit të edicionit (p.sh. 4 gusht – 4 shtator 2025).



Vendimi për licencim: publikohet brenda 7 ditëve nga miratimi nga Bordi i FBK-së.



Komunikimi bëhet përmes emailit zyrtar dhe publikimit në uebfaqen e FBK-së.

**PSE NUK DUHET
TË APLIKOHET
POENTIMI NË
EDICIONIN
2025/26?**



Qëllimi i licencimit është përmbushja e standardeve bazë, e jo rangimi i klubeve sipas performancës relative. Çdo klub duhet të përmbushë të gjitha kriteret bazë për të marrë licencën, jo të kompensojë dobësitë me pikë në fusha të tjera.



Poentimi nuk ka kuptim në mungesë të shpërblimeve konkrete. Nëse nuk ekziston një mekanizëm shpërblimi për klubet që renditen më lart, poentimi shndërrohet në një listë teknike që nuk ka ndikim real.



Fokusi i këtij edicioni është vendosja e standardit të ri, përfshirë obligimin për ndarjen e 10% të buxhetit vjetor për gjeneratat e reja. Kjo është një ndërhyrje madhore dhe kërkon kohë për të matur efektin dhe për të ndërtuar bazën e monitorimit.

AFATET

NJOFTIMI I KLUBEVE

4 Gusht 2025

**VLERËSIMI I APLIKIMEVE
DHE VENDIMI**

15 Gusht-5 Shtator 2025

**PËRFUNDIMI I
PROCESIT TË
LICENCIMIT**

4 Shtator

**DORËZIMI DHE
PLOTËSIMI I
APLIKIMEVE**

4 Gusht-4 Shtator

**TRAJTIMI I
ANKESAVE
NË VENDIM**

6-10 Shtator



JU FALEMINDERIT!